



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 144 Prot.

Tiranë, më datë 10.03.2026

VENDIM

Nr. 86, datë 10.03.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 10.03.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së **Z. Genci Treska** për pajisje me Licencë individuale, në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale, në Zbatim (Z), në kategorinë (V), për nënkategoritë Z/V/2, Z/V/3, Z/V/4, Z/V/5;
2. Mosmiratimin e kërkesës së **Z. Genci Treska** për pajisje me Licencë individuale në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale, në Zbatim (Z), në kategorinë (V) për nënkategoritë Z/V/1, Z/V/6, pasi nuk plotëson numrin e projekteve për këto nënkategori, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 792/2020, Kreu II/“B”, pika 2, shkronja c);
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

KRYETAR
Blendi GONXHJA

